

Vendim nr. 116 datë 29.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 29.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (S) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SAJMIR PRENDI

OBJEKTI: Shfuqizimi pjesërisht i vendimeve nr. 402, datë 09.05.2017 të Komisionit të Vlerësimit të Testit Profesional; nr. 12, datë 09.05.2017 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës; nr. 14, datë 15.05.2017 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Shfuqizimi i vendimeve nr. 890, datë 05.03.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 00-2022-3828, datë 01.12.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 33, 35, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 49, 71/a, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Sajmir Prendi në datat 21 dhe 27 prill 2017 ka marrë pjesë në provimin e pranimit të Shkollës së Magjistraturës (*Shkolla*) për vitin akademik 2017-2018. Në datën 05.05.2017, në përfundim të procesit të vlerësimit, Komisioni i Vlerësimit ka shpallur rezultatet e vlerësimit, nga ku rezulton se paditësi kishte grumbulluar në total 171.3 pikë, duke mos qenë kështu pjesë e listës së kandidatëve fitues.

2. Duke mos qenë dakord me këtë vlerësim, me ankimin e datës 10.05.2017, drejtuar Shkollës, kërkuesi ka kërkuar rivlerësimin (rikorrigjimin) e tezës. Me vendimin e datës 09.05.2017, Komisioni i Korrigjimit të Testit Profesional, pasi ka shqyrtuar ankimet e paraqitura nga disa kandidatë konkurrentë, përfshirë kërkuesin, ka vendosur mospranimin e tyre.

3. Me vendimin nr. 12, datë 09.05.2017, Këshilli Drejtues i Shkollës ka miratuar listën e rezultateve të testimit profesional (me shkrim) të konkurrentëve në provimin e pranimit për vitin akademik 2017-2018, sipas tabelës bashkëlidhur vendimit. Kurse me vendimin nr. 14, datë 15.05.2017, Këshilli Drejtues i Shkollës ka vendosur të miratojë listën e renditjes së kandidatëve me rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni i Provimit me shkrim dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik të provimit të pranimit për vitin akademik 2017-2018, sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.

4. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin pjesërisht të vendimeve nr. 402, datë 09.05.2017 të Komisionit të Vlerësimit, nr. 12, datë 09.05.2017 dhe nr. 14, datë 15.05.2017 të Këshillit Drejtues të Shkollës, si dhe renditjen e tij në listën përfundimtare sipas vlerësimit të kryer mbi tezën e provimit nga ekspertë (pedagogë/akademike të fushës) të caktuar nga gjykata.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3143, datë 17.07.2017, ka vendosur: “*Rrëzimin e padisë së paraqitur nga paditësi Sajmir Prendi, si të pabazuar në ligj e në prova.*”. Gjykata ka vlerësuar se në aneksin 6 të Rregullores së Brendshme të Shkollës, në pikën 3.2.4., janë parashikuar shkaqet ligjore të mundshme për rishikimin e

rezultatit të konkursit, ndërsa në ankimin administrativ dhe atë gjyqësor nuk është pretenduar për asnjërin prej këtyre shkaqeve, por për parregullsi në vlerësimin e testit të provimit dhe rezultatin përfundimtar të provimit. Sipas saj, ndonëse nga paditësi nuk është pretenduar për shkelje procedurale, në aspektin e respektimit të procedurës në nxjerrjen e aktit administrativ objekt gjykimi, konstatohet se vendimi objekt gjykimi është në përputhje të plotë me procedurën e parashikuar në Rregulloren e Brendshme të Shkollës. Në lidhje me pretendimin për parregullsi në korrigjimin e testit, si dhe për vlerësimin ose rezultatin përfundimtar të provimit, gjykata ka vlerësuar se nuk ka asnjë tagër ligjor për të bërë vlerësimin e rezultateve të provimit, çka është atribut ligjor vetëm i jurisë së vlerësimit. Gjithashtu, ajo ka konstatuar se ngritja dhe përbërja e Komisionit të Vlerësimit Profesional është në përputhje me nenin 266, pika 4, të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (ligji nr. 115/2016), si dhe nenin 18, pika 2, të Rregullores së Brendshme të Shkollës (shih faqet 15 dhe 16 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë). Kundër këtij vendimi kërkuar ankim në gjykatën e apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit, duke vlerësuar se duhej të përsëritej marrja e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë, ka riçelur pjesërisht hetimin gjyqësor në përputhje me nenin 465 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) për të administruar tezën e provimit të kërkuar. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 890, datë 05.03.2018, ajo ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 3143, datë 17.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”. Sipas saj, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka analizuar drejt e në kuptim të nenit 17/2 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012) saktë faktet dhe veprimet e lidhura me këtë mosmarrëveshje, duke identifikuar dispozitat e detyrueshme për t'u zbatuar në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes dhe duke i interpretuar ato në mënyrë korrekte (shih faqen 27 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit). Kundër këtij vendimi kërkuar rekurs në Gjykatën e Lartë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3828, datë 01.12.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se nuk ngre shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Sipas tij, shkaqet e parashtruara në rekurs nuk ngrenë problematika të zbatimit të gabuar të ligjit të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk parashtrojnë një qëndrim të ndryshëm të gjykatës së faktit nga vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit

Administrativ, si dhe nuk konstatohet që gjykimi i zhvilluar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë të ketë pasur shkelje të rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose procedurës së gjykimit. Nga analiza tërësore e akteve bashkëlidhur dosjes gjyqësore, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe shkaqeve të parashtruara në rekurs, vendimmarrja e gjykatës së apelit është rrjedhojë e një analize të plotë të fakteve dhe ligjit të zbatueshëm mbi mosmarrëveshjen në gjykim. Në vlerësimin e Kolegjit Administrativ, pretendimet në rekurs ngrenë çështje të vlerësimit të provave, të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 18 dhe 19 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

8. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të mësipërm, kërkesë e cila është regjistruar në datën 24.03.2023.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se aktet objekt ankimi cenojnë:

9.1. *Të drejtën për proces të rregullt në drejtim të:*

9.1.1. *Së drejtës për shqyrtim efektiv të ankimit në mënyrë të pavarur*, pasi Këshilli Drejtues i Shkollës duhej të kishte një vendimmarrje të arsyetuar që t`u përgjigjej në mënyrë specifike të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankim. Vendimi nr. 12, datë 09.05.2017, me të cilin Këshilli Drejtues ka miratuar listën e rezultateve të testit profesional, në përmbajtje të tij nuk shprehet për ndonjë kërkesë ankimore dhe mban vetëm nënshkrimin e drejtuesit, ndërsa vendimi nr. 14, datë 15.05.2017, i cili ka miratuar listën me renditjen e kandidatëve, është nënshkruar nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Një prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, I.P., nuk plotësonte kriteret e pikës 4 të nenit 266 të ligjit nr. 115/2016, pasi nuk ka qenë pedagog me eksperiencë mësimdhënie në Shkollë mbi 5 vjet, por për vitet akademike 2011-2015 ka qenë specialist ose ekspert i fushës pranë saj. Konflikti i interesit në kuptim të nenit 30 të Kodit të Procedurës Administrative (KPA), i anashkaluar nga Shkolla, ka paragjykuar procesin, pasi ishte një pengesë ligjore që ky person të rimerrte pjesë në shqyrtimin e ankimit të kërkuesit.

9.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi kërkuesit nuk i është dhënë akses për t`u njohur në mënyrë të plotë me të gjitha faktet rreth procedurës

së ndjekur për vlerësimin e provimit. Shkolla ndjek një praktikë konsultimit të kandidatit me tezën prej 30 minutash, që është kohë e pamjaftueshme për t'u thelluar në detaje, për më tepër kur nuk lejohet marrja e kopjes së tezës së provimit. Gjykata Administrative e Apelit ka kërkuar si provë shkresore tezën e provimit dhe pas administrimit të saj në dosje nuk ka ndërmarrë asnjë hap procedural në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm. Kërkuesi ka kërkuar thirrjen e një grupi ekspertësh me njohuri të posaçme që lidhen me shkakun ligjor të padisë dhe atë çfarë synonte të arrinte, kërkesë që nuk është pranuar nga gjykata. Gjatë gjykimit është provuar se ka pasaktësi matematikore në mbledhjen e rezultatit dhe shkelje të rënda procedurale dhe qoftë për këtë shkak duhej të caktohej ekspert, pasi as gjykata dhe as kërkuesi nuk mund ta realizonte këtë proces.

9.1.3. *Standardit të arsytimit*, pasi gjykata e apelit ka shtrembëruar rrethanat e çështjes kur shprehet se ankimi administrativ dhe gjyqësor nuk janë mbështetur në shkelje procedurale sipas pikës 3.2.4. të Rregullores së Shkollës, ndërkohë që parregullsitë matematikore janë një nga aspektet më të kontestuara të procesit të vlerësimit të provimit. Në verifikimin e kryer në tezën e provimit nga kërkuesi, veçanërisht mbi kazusin civil, vlerësimi rezultonte me shënimin “5 pikë” dhe poshtë në fletë numrat 2, 3, 1, 4 dhe 2, pa asnjë shënim ose shpjegim tjetër, që nëse mbledhen japin rezultatin 12 pikë. Në kushtet që ankimi administrativ është bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor, në tezë janë bërë ndërhyrje për të ndryshuar këto anomali, duke bërë shënime shtesë, çka ka bërë që rezultati në tezë të mos jetë 5 ose 12, por -2 (minus 2). Shkelje tjetër është edhe vlerësimi në tezën e procedurës penale, ku referuar vlerësimit me pikë ai është 29.3, kurse referuar pikëve të komisionit është 30 dhe shpjegimi për 0.7 pikë më tepër dhe nga cila përgjigje rezulton ajo, mbetet i paarsyetuar e i paargumentuar.

9.1.4. *Parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme*, pasi argumentet e parashtruara në rekurs ishin në përputhje me përcaktimet e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, ndaj ato duhej të ishin pranuar. Shkolla e ka ushtruar veprimtarinë e saj vlerësuese në shkelje dhe tejkalim të ligjit, duke ushtruar një diskrecion jashtë parashikimeve ligjore. Referuar tezës së kërkuesit është e pamundur të

evidentohen normat, parimet ose standardet mbi të cilat është kryer vlerësimi i njohurive të tij nga komisioni, ndërkohë që vlerësimi është bazuar në kriteret të personalizuar dhe subjektive. Aktet që u referohet gjykata, anekset 2 dhe 6, të Rregullores së Shkollës, nuk përmbushin përcaktimet e nenit 266, pika 2, të ligjit nr. 115/2016.

- 9.2. *Të drejtën për arsim dhe atë për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit procedural dhe material si gjatë shqyrtimit administrativ, ashtu edhe atij gjyqësor, si dhe situatës aktuale që kërkuesi nuk është lejuar të vijoje studimet në Shkollën e Magjistraturës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në kuptim të së drejtës për proces të rregullt kërkuesi ka pretenduar edhe se vendimi nr. 12, datë 09.05.2017, me të cilin Këshilli Drejtues i Shkollës ka miratuar listën e rezultateve të testit profesional mban vetëm nënshkrimin e drejtuesit, ndërsa vendimi nr. 14, datë 15.05.2017, që ka miratuar listën me renditjen e kandidatëve, është nënshkruar nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vëren se ai është ngritur për herë të parë në ankimin kushtetues individual dhe nuk rezulton të jetë parashtruar më parë në ankimet e paraqitura në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në këtë drejtim.

15. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e së drejtës për arsim dhe për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, pavarësisht se nuk janë parashtruar si të tilla në ankim dhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ato qëndrojnë në thelb të kërkimeve të kërkuesit. Për rrjedhojë, vlerësohet se në lidhje me to kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

16. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 01.12.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 23.03.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për shqyrtim efektiv të ankimit të tij dhe në mënyrë të pavarur, pasi Këshilli Drejtues i Shkollës duhej të kishte marrë vendim të arsyetuar që t’u përgjigjej në mënyrë specifike të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankim. Po ashtu, sipas tij, një prej anëtarëve të Komisionit

të Vlerësimit, I.P., nuk plotësonte kriteret e pikës 4 të nenit 266 të ligjit nr. 115/2016, pasi nuk ka qenë pedagog me eksperiencë mësimdhënie në Shkollë mbi 5 vjet, por për vitet akademike 2011-2015 ka qenë specialist ose ekspert i fushës pranë saj. Konflikti i interesit, në kuptim të nenit 30 të KPA-së, që ishte një pengesë ligjore për këtë person që të rimernte pjesë në shqyrtimin e ankimit të kërkuarit, i anashkaluar nga Shkolla, e ka paragjykuar procesin. Në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike kërkuar ka pretenduar se Shkolla e ka ushtruar veprimtarinë e saj vlerësuese në shkelje dhe në tejkalim të ligjit, duke ushtruar një diskrecion jashtë parashikimeve ligjore. Referuar tezës së kërkuarit është e pamundur të evidentohen normat, parimet ose standardet mbi të cilat është kryer vlerësimi i njohurive të tij nga komisioni, ndërkohë që vlerësimi është bazuar në kriteret të personalizuar dhe subjektive dhe aktet të cilave u referohet gjykata, anekset 2 dhe 6, të Rregullores së Shkollës, nuk përmbushin përcaktimet e nenit 266, pika 2, të ligjit nr. 115/2016. Sipas kërkuarit, është cenuar edhe e drejta për arsim dhe për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit procedural dhe material si gjatë shqyrtimit administrativ, ashtu edhe atij gjyqësor, çka ka sjellë situatën aktuale ku ai nuk është lejuar të vijojë studimet në atë Shkollë.

18. Sipas jurisprudencës kushtetuese, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit që vënë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Bazuar në këto standarde, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit si më sipër kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore, pra me mënyrën e zbatimit të ligjit nga organi administrativ dhe interpretimit të tij nga gjykatat e zakonshme dhe nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Për më tepër rezulton se gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim dhe u kanë kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuarit si në lidhje me mënyrën dhe kriteret ligjore për zgjedhjen e anëtarit të

komisionit të vlerësimit, ashtu edhe në lidhje me metodologjinë e vlerësimit të kandidatëve në përfundim të provimit të pranimit në Shkollë.

20. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për arsim dhe për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, Kolegji vlerëson se ai nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi kërkuesit nuk i është ndaluar aksesit në çdo funksion publik ose veprimtari që lidhet me profesionin e juristit, por potencialisht vetëm në ushtrimin e detyrës së magjistratit. Në këtë aspekt, të gjitha profesionet e tjera, potencialisht të mundura për kërkuesin, garantojnë të drejtën për fitimin e mjeteve të jetesës me punë të ligjshme. Për më tepër, kalimi me sukses i provimit të pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollë, nuk nënkupton domosdoshmërisht fitimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit të magjistratit, pasi një gjë e tillë është e ndërruar nga përfundimi me sukses i këtij programi, sikundër edhe nga suksesi i kalimit të proceseve të tjera ligjore deri në emërimin dhe fitimin e statusit të magjistratit.

21. Në këndvështrim të pretendimit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, kërkuesi ka pretenduar se nuk i është dhënë akses për t'u njohur në mënyrë të plotë me të gjitha faktet rreth procedurës së ndjekur për vlerësimin e provimit. Sipas tij, praktika e ndjekur për konsultimin e kandidatit me tezën e provimit për 30 minuta është kohë e pamjaftueshme për tu thelluar në detaje, për më tepër kur nuk lejohet marrja e kopjes së saj. Në lidhje me këtë aspekt të këtij pretendimi, Kolegji vëren se kërkuesi ka pranuar në ankimin kushtetues se atij nuk i është mohuar e drejta të njihet me tezën e provimit, rezultatin e së cilës ai e ka kundërshtuar në gjykatat e zakonshme. Pretendimi se koha e vënë në dispozicion nga Shkolla nuk ishte e mjaftueshme dhe se ajo nuk e ka pajisur me kopje të tezës së provimit, ndërkohë që ai ka pasur mundësi të verifikojë mënyrën e vlerësimit dhe pikëzimin, nuk përbën shkelje të nivelit kushtetues, për më tepër që kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument në lidhje me detyrimin e Shkollës për të pajisur kandidatët me kopje të këtyre tezave pas përfundimit të provimit.

22. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me pretendimet e mësipërme, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim.

23. Kolegji vëren, gjithashtu, se në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, kërkuesi ka pretenduar se argumentet e parashtruara në rekurs ishin në përputhje me përcaktimet e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, ndaj ato duhej të ishin pranuar nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, në zbatim të parimit *iuria novit curia*, këto pretendime do të trajtohen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit

24. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit ka shtrembëruar rrethanat e çështjes kur shprehet se ankimi administrativ dhe gjyqësor nuk janë mbështetur në shkelje procedurale sipas pikës 3.2.4. të Rregullores së Shkollës, ndërkohë që parregullsitë matematikore janë një nga aspektet më të kontestuara të procesit të vlerësimit të provimit. Në verifikimin e kryer nga kërkuesi në tezën e provimit, te kazusi civil vlerësimi rezultonte me shënimin “5 pikë” dhe poshtë në fletë ishin numrat 2, 3, 1, 4 dhe 2, por pa asnjë shënim ose shpjegim tjetër, që nëse mblidhen japin rezultatin 12 pikë. Në kushtet kur ankimi administrativ është bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor, në tezë janë bërë ndërhyrje për të ndryshuar këto anomali, duke bërë shënime shtesë, çka ka sjellë që rezultati në tezë të mos jetë 5 ose 12, por -2 (minus 2). Shkelje tjetër është edhe vlerësimi në tezën e procedurës penale, ku referuar vlerësimit me pikë ai është 29.3, kurse referuar pikëve të komisionit është 30, dhe shpjegimi për 0.7 pikë më tepër dhe nga cila përgjigje mbetet i paarsyetuar ose i paargumentuar. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se argumentet e parashtruara në rekurs ishin në përputhje me përcaktimet e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, ndaj ato duhej të ishin pranuar për shqyrtim nga Gjykata e Lartë.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 23, datë 10.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata rithekson se detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse,

por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Kolegji vëren se vendimet gjyqësore të kundërshtuara paraqiten të rregullta në formë, të qarta, koherente dhe pa kundërthënie në përmbajtje. Ato pasqyrojnë në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, pretendimet e palëve në proces, ligjin e zbatueshëm, si dhe arsyetimin dhe vlerësimin për çështjen. Gjykata e apelit, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të tij të parashtruara në ankim. Edhe pse sipas kërkuarit pretendimet e tij kanë të bëjnë me pasaktësi matematikore në përlogaritjen e pikëve, referuar thelbit të pretendimeve të parashtruara në ankimet e paraqitura në gjykatat e zakonshme, ato kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit dhe rezultatin përfundimtar dhe jo me llogaritjen përfundimtare të pikëve të marra prej tij. Edhe pse në ankimin kushtetues kërkuari ka pretenduar se në tezën e provimit është ndryshuar vlerësimi i tij në pikë dhe se ajo është modifikuar, ai nuk ka sjellë prova për të mbështetur këtë pretendim dhe as nuk ka arritur të argumentojë se rezultati përfundimtar në pikë i provimit të tij është i pasaktë për shkak të llogaritjes matematikore të rezultuar nga pikët e marra për secilën tezë/kazus.

28. Edhe Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e parashtruara në rekurs, i ka kthyer përgjigje kërkuarit se përse nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Vetëm fakti se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari, nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor.

29. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

30. Sipas kërkuarit, Gjykata Administrative e Apelit ka kërkuar si provë shkresore tezën e provimit dhe pas administrimit të saj nuk ka ndërmarrë asnjë hap procedural në funksion të një hetimi të plotë e të gjithanshëm. Kërkuari ka kërkuar thirrjen e një grupi ekspertësh me njohuri të posaçme që lidhen me shkakun ligjor të padisë dhe atë çfarë synonte të arrinte, kërkesë që nuk është pranuar nga gjykata. Sipas tij, gjatë gjykimit është provuar se ka pasaktësi matematikore në mbledhjen e rezultatit dhe shkelje të rënda procedurale dhe qoftë për këtë shkak duhej të caktohej ekspert, pasi as gjykata, as kërkuari nuk mund ta realizonte këtë proces.

31. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në jurisprudencë të vazhdueshme, Gjykata ka theksuar se është gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr.9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së armëve nuk i imponon gjykatës që të pranojë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr.19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në këndvështrim të këtyre standardeve, Kolegji vëren se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar nuk rezulton që kërkuuesi të jetë vënë në pozita të pabarabarta me palën tjetër në gjykim. Atij i është dhënë mundësia të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tij, si dhe të kundërshtojë prapësimet e palës tjetër. Për më tepër, rezulton se me vendimin e ndërmjetëm të datës 30.11.2017, kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe riçeljen pjesërisht të hetimit gjyqësor, në përputhje me nenin 465 të KPC-së, për të administruar tezën e provimit të kërkuessit, duke urdhëruar palën e paditur që ta paraqesë atë në seancë gjyqësore. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se vetëm fakti që gjykata nuk ka pranuar kërkesën për thirrjen e ekspertëve dhe fakti se nuk është shprehur në vendim për përmbajtjen e tezës së provimit, nuk vë në dyshim respektimin e parimit të barazisë së armëve, për sa kohë që gjykata ka arsyetuar në mënyrë të plotë në vendim shkaqet ku ka mbështetur qëndrimin e saj.

34. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

35. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.